



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr. 4676 Prot.

Tiranë, më 14.10. 2015

URDHËR

Nr. 434 datë 14.10.2015

PËR  
MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË MBI EDUKIMIN DHE TRAJNIMIN PËR  
MBROJTJEN DHE SIGURINË NGA RREZATIMET JONIZUESE  
DHE HAPAT PËR ZBATIM

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe bazuar në ligjin nr., Ligji Nr.8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar neni 18 i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 543, datë 7.7.2010, “Për punë të sigurt me burimet e rrezatimeve jonizuese”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e dokumentit të mbi edukimin dhe trajnimin për mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimet jonizuese dhe hapat për zbatim.
2. Ngarkohet Zyra për Mbrojtjen nga Rrezatimet për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



**POLITIKAT MBI EDUKIMIN DHE TRAJNIMIN PËR  
MBROJTJEN DHE SIGURINË NGA RREZATIMET  
JONIZUESE DHE HAPAT PËR ZBATIM**

## **PËRMBAJTJA**

1. HYRJE
2. SISTEMI I EDUKIMIT DHE TRAJNIMIT PËR SIGURINË DHE MBROJTJEN NGA RREZATIMET
3. AKTORËT QË LIDHEN ME EDUKIMIN DHE TRAJNIMIN NË LIDHJE ME MBROJTJEN NGA RREZATIMET
4. STATUSI I SIGURISË DHE MBROJTJES NGA RREZATIMI NË EDUKIM
5. SFIDAT
6. TRAJNIMI NË FUSHËN E MBROJTJES NGA RREZATIMI
7. EDUKIMI
8. ZBATIMI I POLITIKAVE, NDARJA E PËRGJEGJËSIVE PËR ZBATIMIN E POLITIKAVE KOMBËTARE PËR E&T
9. TË PËRGJITHSHME

## **LISTA E SHKURTIMEVE**

MSH-Ministria e Shëndetësisë

MAS-Ministria e Arsimit dhe Sportit

E&T-Edukim dhe Trajnim

KMR-Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet

BE-Bashkimi Evropian

UPT-Universiteti Politeknik i Tiranës

IFBZ-Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar, Qendra Kombëtare e Trajnimit.

FIMIF-Fakulteti i Inxhinierisë Fizike dhe Matematike

RSH-Republika e Shqipërisë

ANEA- Agjensia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike

## **1. HYRJE**

Përcaktimi dhe miratimi i politikave kombëtare për trajnimin dhe edukimin në lidhje me përdorimin e burimeve të rrezatimit jonizues, do të bëhet brenda kuadrit të përgjithshëm të legjislacionit shqiptar për edukimin dhe trajnimin në lidhje me mbrojtjen, sigurinë dhe sigurimin nga rrezatimi jonizues në Shqipëri.

### **Vizioni për Shqipërinë**

“Në përputhje me kërkesat e Bashkimi Evropian (BE) dhe ANEA-s për Edukim dhe Trajnim, studentët dhe punonjësit që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimi jonizues do të jenë pjesë, siç përshkruhet në këtë dokument, duke përcaktuar institucionet zyrtare për edukim dhe trajnim, të cilat ofrojnë edukim dhe trajnim, si dhe njohuri të përshtatshme lidhur me nevojat për të siguruar mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimet jonizuese”.

KMR-ja, në bashkëpunim me ministrinë përkatëse, do të planifikojnë të gjithë programin për edukim dhe trajnim nëpërmjet Universitetit Politeknik dhe Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar (IFBZ) si Qendrës Kombëtare të Trajnimit. Dokumenti i politikave kombëtare për Edukim dhe Trajnim (E&T) është përgatitur nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMR) në bashkëpunim me institucionet që lidhen me edukimin dhe trajnimin.

Modulet për të prezantuar edukimin për sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimi duhet të zhvillohen në mënyrë të plotë të studentët për të gjitha llojet e specializimeve dhe nevojave në këtë fushë. Trajnimet ekstra-kurikulare duhet të hartohen për të mbështetur zhvillimet në industri, kërkimet shkencore, mjekësinë etj., të lidhura me zhvillimet e vendit.

## **2. SISTEMI I EDUKIMIT DHE TRAJNIMIT PËR MBROJTJEN NGA RREZATIMI**

Aktualisht, të gjithë përdoruesit e rrezatimit jonizues kanë informacion në lidhje me programet e trajnimit në Shqipëri nëpërmjet procesit të licencimit. Promovimi i aftësive të mbrojtjes nga rrezatimi është gjithashtu një element i rëndësishëm i edukimit dhe trajnimit.

Edukimi dhe Trajnimi për mbrojtjen nga rrezatimi ka të bëjë me zhvillimin e aftësive dhe cilësive personale në mënyrë që, njerëzit të kuptojnë dhe fitojnë njohuri mbi mënyrën sesi të mbrohen nga rrezatimi jonizues. Kjo përfshin qasjet për zhvillimin e koncepteve të mbrojtjes, zgjidhjen e problemeve, grupin e punës, rreziqet e llogaritura që duhen marrë parasysh, aftësitë e komunikimit, udhëheqjen, vendimmarrjen, menaxhimin e kohës, marrjen e përgjegjësive dhe aftësitë e tjera individuale, të cilat çojnë në përmirësimin e mbrojtjes nga rrezatimi.

Ekziston nevoja që zhvillimi i edukimit dhe trajnimit për sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimi të vazhdojë përtej kuadrit shkollor, duke marrë parasysh nevojën e të mësuarit gjatë gjithë jetës, të ofrojë aftësi personale shtesë, si dhe të mbështesë rritjen e përdorimit të teknikave të rrezatimit jonizues.

Edukimi dhe Trajnimi për mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimi jonizues gjithashtu identifikon rolin e institucioneve përbërëse, si dhe kërkesat e ndryshme. Metodologjia për kryerjen e një

pakete të tillë edukimi dhe trajnimi bëhet nëpërmjet institucioneve që janë pjesë e këtij dokumenti.

Për të arritur zhvillimet në edukimin dhe trajnimin për mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimi, është e nevojshme rritja në mënyrë të konsiderueshme e kapaciteteve të të gjitha institucioneve të përfshira në këtë proces. Kjo do të realizohet përmes krijimit dhe përmirësimit të sistemit të edukimit dhe kurseve kombëtare, të përshtatshme për të gjithë njerëzit e përfshirë në përdorimin dhe kontrollin e rrezatimeve jonizuese.

Qendra Kombëtare e Trajnimit në Shqipëri, e cila do të jetë dhe pikë referimi për zhvillimin e trajnimit për mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimi, do të sigurojë certifikimin për të përmbushur kriteret e BE-së dhe ANEA-s. Kjo do të kërkojë koherencë të mëtijshme të dispozitës ekzistuese dhe krijimin e qasjeve të reja për zhvillimin e programeve.

Standardet për edukimin në këtë fushë, janë zhvilluar dhe do të zhvillohen dhe në të ardhmen duke u bazuar në kriteret ndërkombëtare. Ato kanë nevojë për përmirësim të mëtijshëm që të jenë në përputhje me kërkesat e BE-së dhe ANEA-s. Këto standarde, në mënyrë që të formojnë bazën e zhvillimit të edukimit dhe trajnimit për sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimi, do të lidhen me identifikimin e niveleve në Sistemin Evropian të Kualifikimeve, në mënyrë që Shqipëria të përmbushë kërkesat në të ardhmen.

### **3. AKTORËT QË LIDHEN ME EDUKIMIN DHE TRAJNIMIN NË LIDHJE ME MBROTJEN NGA RREZATIMET JONIZUESE**

KMR-ja, Fakulteti i Inxhinierisë Fizike dhe Matematike (FIMIF) dhe IFBZ janë aktorët kryesorë për E&T. FIMIF-i do të jetë bazë e sistemit të edukimit në Republikën e Shqipërisë sidomos për përgatitjen e fizikanëve mjekësorë.

IFBZ-ja do të jetë Qendra Kombëtare e Trajnimit për të gjitha grupet e interesit që lidhet me mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimet jonizuese.

KMR-ja miraton programet në përputhje me politikat e strategjitë për mbrojtjen nga rrezatimi në Republikën e Shqipërisë.

KMR-ja njeh diplomat e studimit në sistemin e mbrojtjes nga rrezatimet për të gjitha profesionet që lidhen me rrezatimet jonizuese të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS).

### **4. STATUSI I SIGURISË DHE MBROJTJES NGA RREZATIMET NË EDUKIM**

Në Shqipëri ekziston një sistem për mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimi, i cili shërben si një udhëzues për E&T. Përmirësimi i këtij sistemi në Shqipëri bëhet që të arrijë në një nivel të përshtatshëm me BE-në dhe ANEA-n. Me qëllim që të ngrihet kompetenca në nivelet e duhura në përputhje me nevojat e vendit, është e nevojshme të njihen aktivitetet dhe instalimet me rrezatim jonizues. Për vlerësimin e këtyre nevojave, në lidhje me krijimin e një sistemi të integruar për edukimin dhe trajnimin, është e nevojshme të vlerësohet informacioni bazë mbi aktivitetet dhe instalimet e rrezatimit jonizues në Shqipëri.

Numri dhe lloji i aktiviteteve të deritanishme apo të parashikuara për 10 vitet e ardhshme.

a. Qendra të licencuara nga KMR-ja për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues në fushën e industrisë.

Këto përfshijnë qendra me burime nga kategoria 1 deri në kategorinë 5.

b. Qendra të licencuara nga KMR-ja për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues në fushën e mjekësisë.

-Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Departamenti i Radioterapisë (burime të mbyllura radioaktive, kategoria I dhe III)

-Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Departamenti i Mjekësisë Bërthamore (burime të hapura radioaktive Mo-99/Tc-99m dhe I-131, Diagnostikim dhe Terapi)

-Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Departamenti i Radiologjisë (gjeneratorë me rreze X, CT-skaner, grafi, skopi, angiografi, mamografi, C-Arm)

-Spitali Nr.5 (Akselerator Linear, CT-Simulator dhe një burim kalibrimi Sr-90)

-Spitali Hygeia (Akselerator Linear, grafi, mamografi, si dhe I-131 dhe Mo-99/Tc-99m)

-Spitali Amerikan (Departamenti i Mjekësisë Bërthamore I-131 dhe Mo-99/Tc-99m si dhe Departamenti i Radiologjisë)

c. Qendra e licencuar nga KMR-ja për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues në fushën e shkencës

Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar (burime të mbyllura dhe të hapura radioaktive, kategoria I, III, IV dhe V, si dhe gjeneratorë me rreze X).

#### **4.1 Kuadri ligjor, rregullator në lidhje me edukimin dhe kërkesat e trajnimit**

Ligji Nr.8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar.

Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr.10, datë 7.1.2010 “Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese”, neni 3, “... ekspertiza në lidhje me mbrojtjen nga rrezatimet, sigurinë dhe sigurimin realizohet nga përdoruesit, persona fizik e juridik me mbështetjen e ekspertëve në këto fusha (të njohur nga ana e KMR-së);

VKM-ja Nr. 543, datë 7.7.2010, “Për punë të sigurt me burimet e rrezatimeve jonizuese” neni 17 (a) përcakton se: Personeli nga i cili varet mbrojtja, siguria dhe sigurimi duhet të jetë i kualifikuar dhe i trajnuar;

Gjithashtu, neni 18 (1 dhe 2) i kësaj rregulloreje përcakton se: Zbatimi i standardeve dhe sigurimi i këshillave bëhet nga ekspertë të kualifikuar që duhet të përcaktohen për qëllimet e

mësipërme; si dhe Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi duhet të përcaktojë kritere të qarta për ekspertët e kualifikuar.

VKM-ja Nr.229, datë 20.3.2013 “Për sigurinë ndaj ekspozimeve mjekësore me burime të rrezatimit jonizues” pika 2.2 (c), ku përcaktohet se: Personeli mjekësor dhe paramjekësor të ketë marrë trajnimin e duhur, të mjaftueshëm për të kryer detyrat e ngarkuara, në zbatim të procedurës diagnostikuese apo terapeutike që rekomandon mjeku.

Gjithashtu, pika 4.3(b) e rregullores më sipër, përcakton se, personat fizikë/juridikë të licencuar duhet të marrin të gjitha masat për të parandaluar dështimet dhe gabimet, duke përfshirë zgjedhjen e personelit të përshtatshëm, të kualifikuar, si dhe ritrajnimin periodik, vendosjen e procedurave për kalibrimin, sigurinë e cilësisë për funksionimin e pajisjeve diagnostikuese dhe terapeutike;

Programi i Trajnimit në fushën e Mbrojtjes nga Rrezatimi, Nr. 1438/6 datë 12.4.2011 ose amenduar.

KMR-ja nëpërmjet dokumentit themelor që lidhet me trajnimin në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, sigurisë dhe sigurimit, shtron si detyrë parësore që: “Të identifikohen në mënyrë të qartë përgjegjësitë e çdo individi, duke përfshirë edhe nivelet e larta menaxhuese për mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimet, si dhe çdo individ të jetë trajnuar dhe kualifikuar në mënyrë të përshtatshme”.

Ky dokument shtron si detyrë që: “KMR-ja të sigurojë përgatitjen e një kuadri ligjor adekuat, që kërkon trajnimin e përshtatshëm për të gjithë personelin e angazhuar në veprimtari që lidhen me mbrojtjen, sigurinë e rrezatimeve, si dhe sigurimin fizik të burimeve të rrezatimit jonizues”.

Për të përmbushur kërkesat e mësipërme, del si detyrë që çdo person, i cili ekspozohet ose që mund të ekspozohet profesionalisht ndaj rrezatimeve jonizuese, duhet të trajnohet në mënyrë të përshtatshme për mbrojtjen nga rrezatimi dhe për përdorimin e sigurt të burimeve të rrezatimeve. Trajnimi duhet të lidhet me praktika specifike dhe mund të variojë nga një kurs i shkurtër njëditor për mbrojtje nga rrezatimet, deri në një kurs intesiv disamujor për një ekspert të kualifikuar. Në këto kushte, KMR-ja miraton programin e trajnimit të punonjësve në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, duke përfshirë përgatitjen e programeve të posaçme për personat që duhet të trajnohen duke mbajtur parasysh shkallën e arsimimit, eksperiencën në punë, kualifikimin etj.

Institucionet që kryejnë trajnimin e punonjësve për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues duhet të kenë stafin pedagogjik-specialist të përshtatshëm për kryerjen e trajnimit, i cili duhet të dëshmojë përgatitjen e tij, si dhe bazën e nevojshme materiale për zhvillimin e kurseve. Këto institucione mund të jenë departamente pranë universiteteve, qendra trajnimi etj., por gjithmonë të njohura nga KMR-ja.

## **4.2 Ritrajnimi**

Punonjësit që përdorin burime të rrezatimeve jonizuese dhe që kanë marrë trajnimin përkatës për mbrojtjen nga rrezatimet, duhet t'i nënshtrohen kurseve të ritrajnimit pas një periudhe prej pesë vitesh. Kjo është e nevojshme për të rifreskuar njohuritë e fituara në kursin paraardhës të trajnimit, si dhe për t'u njohur me zhvillimet e reja të mundshme në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet.

Kurset e ritrajnimit si rregull zhvillohen mbi bazën e të njëjtit program me ato të kurseve të trajnimit por, sikurse u theksua më lart, duke mbajtur parasysh si zhvillimet e reja, ashtu dhe faktin që punonjësit tashmë kanë fituar një eksperiencë pune me burimet e rrezatimeve që kanë në përdorim.

## **4.3 Vlerësimi dhe njohja e trajnimit**

Në fund të kursit të trajnimit bëhet një vlerësim i njohurive të fituara, nëpërmjet testimit të pjesëmarrësve. Pas përfundimit të kursit të trajnimit dhe vlerësimit të kryer, pjesëmarrësit duhet të pajisen me një certifikatë, e cila duhet të përmbajë emërtimin e qendrës trajnuese, titullin e kursit të trajnimit, si dhe kohën e zhvillimit të tij. Certifikata nënshkruhet nga autoritetet drejtuese të kursit.

## **4.4 Sillabuset e kurseve për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues**

Sillabuset e kurseve të trajnimit përmbajnë një sillabus themelor, i cili shërben për përvetësimin e bazave të mbrojtjes nga rrezatimet për të gjithë punonjësit ose specialistët, si dhe një sillabus shtesë (të posaçëm), i cili përmban çështje që lidhen me specialitete të veçanta që janë: Radiodiagnostika, Radioterapia (teleterapi dhe brakiterapi), Mjekësia bërthamore, Radiografia industriale, Përdorimi i sondave radioaktive dhe karrotazhit radioaktiv, Punonjësit e trupës rregullatore. Këto sillabuse miratohen nga KMR-ja.

## **4.5 Edukimi dhe trajnimi**

Në Shqipëri ekziston një numër i madh institucionesh dhe qendrash që përdorin burime të rrezatimit jonizues, si në industri, mjekësi, kërkim shkencor dhe edukim. Aktualisht, për pasojë është rritur dhe numri i punonjësve që përdorin këto burime. Aktualisht, në Shqipëri punojnë me burime të rrezatimit jonizues rreth 460 punonjës.

KMR-ja ka njohur 12 ekspertë të kualifikuar dhe 6 fizikanë mjekësorë, ndërkohë janë diplomuar pranë Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT) në FIMIF në Master Profesional, 10 fizikanë mjekësorë.

Megjithëse çdo veprimtari drejtohet nga KMR-ja, kjo praktikë duhet të përmirësohet në përputhje me programin e trajnimit të miratuar nga KMR-ja. Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR) është ngarkuar për inventarin e burimeve radioaktive dhe aktiviteteteve. ZMR-ja përdor

sistemin RAIS (Regulatory Authority Information System) për inventarin dhe ruajtjen e të dhënave që kanë lidhje me materialet radioaktive dhe veprimtaritë.

Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar është përcaktuar nga ana e KMR-së si institucioni qendror për trajnimin e të gjithë punonjësve të rrezatimit, oficerëve të mbrojtjes nga rrezatimi, ekspertëve të kualifikuar, si dhe punonjësve të trupës rregullatore.

IFBZ është përcaktuar nga KMR-ja si qendra kombëtare për testimin e të gjitha kategorive të sipërpërmendura. Testimi i punonjësve të rrezatimit kryhet nga një komision i përbashkët me përfaqësues të IFBZ-së dhe ZMR-së.

#### **4.6 Kategoritë e personave që duhet të trajnohen**

Gjatë zhvillimit të kurseve të trajnimit duhet të mbahet parasysh fakti që shpesh shkalla e përgatitjes së pjesëmarrësve nuk është e njëjtë përsa i përket njohurive bazë. Gjatë përcaktimit të përmbajtjes së programit, duhen mbajtur parasysh ato çështje që kanë lidhje direkte me fushën e zbatimit të rrezatimeve nga pjesëmarrësit. Përcaktimi dhe vendosja e një niveli bazë të kompetencës është çështje me prioritet të lartë për të gjithë personelin. KMR-ja duhet të nxisë procedurat që të vendoset në vend një kulturë e lartë sigurie. Kjo arrihet vetëm në rastin kur të gjithë personat që përdorin burime të rrezatimeve të jenë trajnuar në mënyrë të përshtatshme për të kuptuar sa më drejt përgjegjësitë që kanë dhe të kryejnë detyrat në kushtet e një sigurie të lartë.

Kategoritë e personave që duhet të trajnohen janë:

- Ekspert i kualifikuar
- Përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet,
- Punonjës që përdor burime radioaktive,
- Punonjës i trupës rregullatore.

Përmbajtja dhe niveli i trajnimit për secilën nga këto kategori bazohet në faktorë të tillë si: mundësia e ekspozimit ndaj rrezatimeve, niveli i supervizimit të veprimtarisë, kompleksiteti i punës që do të kryhet, si dhe shkalla e trajnimeve të mëparshme të punonjësit.

#### **4.7 Ekspert i kualifikuar**

Trajnimi për ekspertin e kualifikuar duhet të sigurojë një njohje të gjerë të mbrojtjes, sigurisë nga rrezatimet jonizuese si dhe sigurimit fizik të burimeve radioaktive. Ky nivel njohurish mund të fitohet me arsimim të rregullt, me trajnim të posaçëm dhe me eksperiencë pune. Për më tepër, eksperti i kualifikuar duhet të ketë një njohje të gjithanshme të shumë çështjeve specifike që lidhen me fushat e tij të ekspertizës, si dhe duhet të jetë në dijeni të zhvillimeve të reja në këto fusha. Eksperti i kualifikuar duhet të ketë cilësi personale të spikatura, duke përfshirë

komunikimin, aftësinë analitike dhe udhëheqëse, mbasi ata udhëheqin trajnime dhe japin këshilla për një gamë të gjerë punonjësish si teknikët, menaxherët, specialistët dhe autoritetet qeveritare. Kurset për trajnimin e ekspertëve të kualifikuar do të jenë 3 mujore.

#### **4.8 Përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet**

Trajnimi për përgjegjësit për mbrojtjen nga rrezatimet do të varet shumë nga fusha e zbatimit të rrezatimeve, por të gjitha trajnimet duhet të përmbajnë një sasi të caktuar të informacioneve bazë të mbrojtjes dhe sigurisë. Thellësia e mbulimit të çdo çështjeje do të varet nga praktikat specifike në të cilën personi është trajnuar dhe duhet të mbajë parasysh madhësinë e rrezikut potencial që lidhet me praktikën e zbatuar. Përgjegjësi për mbrojtjen nga rrezatimet duhet të zotërojë disa cilësi personale si: aftësi komunikimi, aftësi udhëheqëse dhe analitike, aftësi kompjuterike, të cilat mund të stimulohen gjatë trajnimit me teori dhe ushtrime praktike.

Kurset për trajnimin e përgjegjësit për mbrojtjen nga rrezatimet do të jenë 3 javore.

#### **4.9 Punonjës që përdorin burime radioaktive**

Punonjësit që janë të ekspozuar ndaj rrezatimeve jonizuese, për shkak të profesionit të tyre, kanë nevojë për trajnim të rregullt lidhur me masat mbrojtëse nga rrezatimet.

Trajnimi mund të variojë nga trajnim njëditor i një punonjësi në afërsi të një sonde të thjeshtë radioaktive që shërben p.sh. për matjen e nivelit (nivelmatës), deri në trajnim prej një ose më shumë javësh për një punonjës të një impianti rrezitës.

Trajnimi i punonjësve për çështje që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë duhet të jetë pjesë përbërëse kryesore e çdo programi të mbrojtjes nga rrezatimet. Trajnimi duhet të kryhet në përputhje me llojin e punës dhe me llojin e burimeve të rrezatimeve. Ai duhet të krijojë te punonjësit shprehitë e nevojshme për të realizuar kurdoherë një punë të sigurt me burimet e rrezatimeve jonizuese.

Programi i trajnimit duhet të garantojë që punonjësit të marrin informacione adekuate dhe të përditësuar për rreziqet shëndetësore që lidhen me ekspozimin profesional, ekspozimin aksidental dhe rëndësinë që ka marrja e masave mbrojtëse.

Trajnimi duhet të rrisë ndërgjegjësimin e punonjësve për respektimin e masave mbrojtëse në vendet e punës (si p.sh. ndalimi i pirjes së duhanit ose i konsumit të ushqimeve). Po ashtu punonjëset në moshë riprodhuese duhet të kenë informacionin e nevojshën lidhur me rrezikun potencial të rrezatimeve ndaj embrionit ose fetusit gjatë shtatëzënisë.

Kurset për trajnimin e punonjësve që përdorin burime të rrezatimit jonizues duhet të jenë disaditore, 3-4 ditë ose dhe më të gjata, duke mbajtur parasysh kërkesat specifike të punës dhe llojit të burimit.

#### **4.10 Punonjës i trupës rregullatore**

Trajnimi i punonjësve të trupës rregullatore do të varet nga detyrat që ata kryejnë, dhe nga rreziku radiologjik potencial i burimeve të rrezatimeve që ata inspektojnë. Kështu, punonjësit që

përfshihen në vlerësimin e sigurisë së rrezatimeve, si dhe në inspektimet e institucioneve që përdorin burime të ndryshme të rrezatimit jonizues, duhet të kalojnë në trajnime të gjata, ndërkohë që një inspektor i sondave industriale duhet të ketë një trajnim bazë për mbrojtjen nga rrezatimet.

Punonjësit e trupës rregullatore duhet të kenë njohuri shumë të mira për standardet dhe praktikën rregullatore që zbatohen në vendet e zhvilluara. Komponentë të rëndësishëm të trajnimit të inspektorëve janë monitorimi i rrezatimeve dhe teknikat e inspektimit.

Gjatë zhvillimit të trajnimit duhet të stimulohen cilësitë personale të punonjësve të trupës rregullatore si komunikimi, analizimi dhe menaxhimi. Kurset për trajnimin e punonjësve të trupës rregullatore do të jenë disaditore, 3-4 ditë ose dhe më të gjata, duke mbajtur parasysh kërkesat specifike për specialistë të veçantë.

#### **4.11 Institucionet që kryejnë trajnimin e punonjësve**

Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar është përcaktuar nga ana e KMR-së si institucioni qendror për trajnimin e të gjithë punonjësve të rrezatimit, oficerëve të mbrojtjes nga rrezatimi, ekspertëve të kualifikuar dhe trupës rregullatore.

ANEA dhe BE gjithashtu kanë mbështetur trajnimin dhe edukimin e një numri të madh stafi në lidhje me sigurinë për mbrojtjen nga rrezatimet.

FIMIF prej tre vjetësh ofron programe edukimi të njohura nga organet kompetente në fushën e fizikës mjekësore. Ky edukim përfshim ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në fizikën mjekësore.

Në këtë fushë ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe dy institucione private, vetëm për trajnimin e punonjësve të angazhuar në punë me burime të rrezatimit jonizues.

### **5. SFIDAT**

Pa dyshim, sfidat më të mëdha për suksesin e politikave kombëtare të E&T për sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimi jonizues janë burimet financiare dhe njerëzore ekzistuese, të cilat janë të kufizuara për zbatim. Nevoja për të rritur këto burime është një sfidë e madhe, e cila do të kërkojë që të gjithë aktorët të punojnë së bashku për arritjen e një rezultati sa më të mirë për Shqipërinë.

### **6. TRAJNIMI NË FUSHËN E MBROJTJES NGA RREZATIMI**

Trajnimi siguron njohuritë teorike dhe kryesisht praktike të nevojshme për punë, me burime të rrezatimit jonizues nëpërmjet leksioneve dhe praktikave.

KMR-ja aprovon programet e trajnimit në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi jonizues.

IFBZ-ja përcaktohet si Qendra Kombëtare e Trajnimit për mbrojtjen nga rrezatimit. Ajo duhet të plotësojë këto kritere:

- a. Program trajnimi, materiale tekst,
- b. Kapacitet njerëzor
- c. Ambient mësimi dhe praktike
- d. Arkiv

Institucionet të cilat plotësojnë kriteret për trajnim mund të bëjnë trajnimin e punonjësve të angazhuar në punë me burime të rrezatimit, mbi bazën e programeve të miratuara nga KMR-ja. Veprimtaria e këtyre institucioneve rregullohet nga KMR-ja.

ZMR-ja bën verifikimin e plotësimin të këtyre kritereve nga ana e institucioneve në lidhje me trajnimin dhe raportin në KMR.

KMR-ja miraton kriteret dhe sillabuset të cilat përgatiten nga IFBZ-ja

## **7.EDUKIMI**

MAS nëpërmjet FIMIF-it, do të jetë institucioni kryesor për përgatitjen dhe diplomimin e fizikanëve mjekësorë, si dhe specializimeve të tjera në bashkëpunim me KMR-në, IFBZ-në, Fakultetin e Shkencave, Fakultetin e Mjekësisë dhe universitete të tjera.

FIMIF përcakton programe të qarta edukimi në përputhje me standardet ndërkombëtare.

KMR-ja konsulton programet e edukimit përpara se ato të miratohen nga MAS-i duke dhënë pëlqimin e tij.

## **8. ZBATIMI I POLITIKAVE, NDARJA E PËRGJEGJËSIVE PËR ZBATIMIN E POLITIKAVE KOMBËTARE PËR E&T**

Institucioni përgjegjës për implementimin e politikave kombëtare për E&T është MAS në bashkëpunim me KMR-në.

KMR-ja është përgjegjëse për aspektet rregullatore në lidhje me trajnimin.

FIMIF do të jetë institucioni bazë për përgatitjen dhe edukimin e fizikanëve mjekësorë në RSH dhe specialistëve të tjerë.

IFBZ-ja do të jetë Qendra Kombëtare e Trajnimit të punonjësve, ekspertëve të kualifikuar, oficerëve të mbrojtjes nga rrezatimi dhe punonjësve të trupës rregullatore.

Edukimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi siguron njohuritë bazë teorike dhe praktike të nevojshme për punë të sigurt me burime të rrezatimit jonizues.

Në Fakultetin e Inxhinierisë Fizike dhe Matematike do të diplomohen fizikanë mjekësorë pasi kryejnë 5 vjet studime, me sistemin 3 vjeçar Bachelor dhe 2 vjet Master.

Njohja nga ana e KMR-së si fizikan mjekësor do të bëhet pas dy viteve punë në qendra që përdorin burime të rrezatimit jonizues.

Në FIMIF ekzistojnë programe (sillabuse) standarde të ciklit pasuniversitar Master, të cilat shërbejnë për përgatitjen e fizikanëve mjekësorë.

## **9. TË PËRGJITHSHME**

Institucionet përgjegjëse do të rishikojnë në mënyrë të rregullt politikat kombëtare për edukimin dhe trajnimin në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi.

E&T për sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimi të përfshihet në kurikulat përkatëse